



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONERI PËR MBIKËQYRJEN E SHËRBIMIT CIVIL

Nr. 454/4 Prot

Tiranë, më 23.10.2023

V E N D I M

Nr. 82, datë 23.10.2023

Mbi përfundimin e procesit të vlerësimit të ligjshmërisë gjatë aplikimit të masës disiplinore, largim nga shërbimi civil dhe paralajmërimin e institucionit të Bashkisë Vlorë për të rregulluar paligjshmërinë e konstatuar

Në mbështetje të kompetencave ligjore të parashikuara në pikën 1, të nenit 11, nenet 14 dhe 15, të ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar, të ligjit nr. 44/2015, “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë”, si dhe Rregullores “Mbi procedurat e mbikëqyrjes/inspektimit”, miratuar me vendimin nr. 17, datë 11.03.2015, të Komisionerit për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil, pas shqyrtimit të relacionit të Drejtorisë së Përgjithshme të Inspektimit dhe Mbikëqyrjes, në përfundim të verifikimit të informacionit të marrë nga nëpunësi i Bashkisë Vlorë, *****,

Vërej se:

Pranë Komisionerit për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil është rregjistruar informacioni me nr. 454 prot., datë 04.05.2023, i paraqitur nga nëpunësi ***** me detyrë “*Specialist Arkitekt*”, në Drejtorinë e Urbanistikës, pranë Bashkisë Vlorë, nëpërmjet të cilit pretendohet se, janë lejuar shkelje të ligjit për shërbimin civil, gjatë procedurës së dhënies së masës disiplinore “*Largim nga shërbimi civil*”, për këtë nëpunës.

Pas shqyrtimit të dokumentacionit që pasqyron veprimet administrative të kryera gjatë zhvillimit të kësaj procedure, rezulton se, punonjësit i është deklaruar statusi si “*nëpunës civil*”, me aktin me aktin nr. 21 prot., datë 18.06.2014.

Në vijim të marrëdhënies së punësimit, nëpunësi ***** është pezulluar nga shërbimi civil, me aktin e pezullimit nr. 3, (nr. 4325 prot.), datë 22.04.2022, të kryetarit të bashkisë, deri në përfundimin e procedurës disiplinore, me motivacionin se, ky nëpunës ka treguar

sjellje të parregullt, në mënyrë të përsëritur gjatë kohës së punës me kolegët, e cila në zbatim të pikës 3, germa ç), të nenit 57, të ligjit nr. 152/2013 *“Për nëpunësin civil”* i ndryshuar, përbën *“shkelje të rëndë”*, ende pa u njoftuar për fillimin e ecurisë disiplinore në ngarkim të tij.

Sipas dokumentacionit të administruar, rezulton se, pas këtij vendimi, kryetari i bashkisë, me Urdhrin e Brendshëm nr. 84, datë 24.04.2022 ka urdhëruar ngritjen e Komisionit të Disiplinës, i cili është mbledhur pas katër ditësh dhe me shkresën nr. 4476, datë 26.04.2022, ka njoftuar nëpunësin ******, për fillimin e ecurisë disiplinore, duke i lënë atij, një afat 15 ditor për paraqitjen e pretendimeve dhe sqarimeve përkatëse.

Konstatohet se, kryetari i bashkisë Vlorë, në shkelje të parashikimeve të nenit 59, të ligjit nr. 152/2013, *“Për nëpunësin civil”* i ndryshuar, si dhe dispozitave të Vendimit nr. 115, datë 05.03.2014, të Këshillit të Ministrave, *“Për përcaktimin e procedurës disiplinore dhe rregullave për krijimin, përbërjen e vendimmarrjen në Komisionin Disiplinor në shërbimin civil”*, të cilat përcaktojnë mënyrën e funksionimit të Komisionit Disiplinor, si dhe pa prituri që Komisioni të mbledhej dhe të trajtonte çështjen, me vendimin nr. 26, (nr. 3585 prot.), datë 23.03.2023, ka dhënë masën disiplinore *“Largim nga shërbimi civil”*, për nëpunësin ******, me detyrë *“Specialist Arkitekt”*, në Drejtorinë e Urbanistikës, në Bashkinë Vlorë.

Përsa u parashtrua, rezulton se, aktet e nxjerra gjatë zhvillimit të ecurisë disiplinore, nga kryetari i bashkisë Vlorë, vijnë në kundërshtim me përmbajtjen e normave ligjore të përcaktuara në legjislacionin e shërbimit civil, të cilat rregullojnë këtë institut të ligjit.

Konkretisht, akti nr. 3, (nr. 4325 prot.), datë 22.04.2022, i kryetarit të bashkisë Vlorë, për pezullimin e nëpunësit ******, vjen në kundërshtim me pikën 1, germa c), të nenit 53 dhe pikën 6, të nenit 59, të ligjit nr. 152/2013 *“Për nëpunësin civil”* i ndryshuar, ku përcaktohet se, pezullimi nga shërbimi civil merret me vendim të Komisionit Disiplinor, në rastet kur ka arsye të besohet se vazhdimi i ushtrimit të detyrës nga nëpunësi civil, ndaj të cilit ka filluar një procedim disiplinor, pengon hetimin administrativ apo mund të cenojë ushtrimin e përshtatshëm të detyrës së tij.

Në këto kushte, rezulton se, në këtë rast, kryetari i bashkisë Vlorë, ka vepruar në mungesë të kompetencës së tij lëndore dhe në kundërshtim me procedurat ligjore duke nxjerrë një akt administrativ absolutisht të pavlefshëm. Për pasojë, në zbatim të germës a), pika 1, të nenit 108, *“Akti administrativ absolutisht i pavlefshëm”*, të ligjit nr. 44/2015, *“Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë”*, akti nr. 3, (nr. 4325 prot.), datë 22.04.2022, duhet të konstatohet si një akt absolutisht i pavlefshëm nga ana e vetë organit që e ka nxjerrë atë.

Ndërkohë, situata e paligjshmërisë ka vijuar më tej, pasi në mungesë të kompetencës dhe në kundërshtim me procedurat, me vendimin nr. 26, datë 23.03.2023, “Për largimin nga detyra”, kryetari i bashkisë ka vendosur largimin nga detyra të nëpunësit *****.

Në këtë rast, kompetencën për të marrë vendimin për largim nga shërbimi civil, në bazë të pikës 2, të nenit 59, të ligjit nr. 152/2013 “Për nëpunësin civil” i ndryshuar, e ka Komisioni i Disiplinës, në këto kushte, akti nr. 26, datë 23.03.2023, i kryetarit të bashkisë, “Për largimin nga detyra”, të nëpunësit ***** është nxjerrë në mungesë të kompetencës së organit publik dhe në kundërshtim me procedurën, si i tillë, në zbatim të germës a), pika 1, të nenit 108, “Akti administrativ absolutisht i pavlefshëm”, të ligjit nr. 44/2015, “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë”, duhet të konstatohet si një akt absolutisht i pavlefshëm nga ana e vetë organit që e ka nxjerrë atë.

Ky akt, referuar nenit 110 dhe nenit 111, të ligjit nr. 44/2015, nuk sjell asnjë pasojë juridike, e në këto kushte, vetë organi publik, që në këtë rast përkon me kryetarin e bashkisë Vlorë duhet të anulohet vendimin nr. 26, datë 23.03.2023, si dhe të vendosë të rikthejë në pozicionin e tij të punës, nëpunësin *****.

Për këto arsye:

Në mbështetje të kompetencës së përcaktuar në nenin 11, pika 1, nenet 14 dhe 15, të ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar; të neneve 108, 110 dhe 111, të ligjit nr.44/2015, “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë”; si dhe në mbështetje të Rregullores “Mbi procedurat e mbikëqyrjes/inspektimit”, miratuar me vendimin nr. 17, datë 11.03.2015, të Komisionerit për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil,

VENDOSA:

Të paralajmërojë institucionin e bashkisë Vlorë, për rregullimin e situatës së ligjshmërisë, në zbatim të kërkesave të ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar, duke vepruar në këtë mënyrë:

1. Kryetari i Bashkisë Vlorë, në zbatim të nenit 108, 110 dhe 111, të ligjit nr. 44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative i RSH”, nëpërmjet një akti të ri me shkrim, duhet të konstatojë pavlefshmërinë absolute të aktit nr. 26, datë 23.03.2023, “Për largimin nga detyra”, të nëpunësit ***** , duke urdhëruar rikthimin në pozicionin e tij të punës si “Specialist Arkitekt” në Drejtorinë e Urbanistikës, në Bashkinë Vlorë si dhe rregullimin e pasojave që kanë ardhur në këtë rast.

2. Të konstatohet pavlefshmëria absolute e aktit nr. 3, datë 22.04.2022, për pezullimin e nëpunësit *****, nga ana e Kryetarit të Bashkisë Vlorë, në përputhje me kërkesat e nenit 108, 110 dhe 111, të ligjit nr.44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative i RSH”.
3. Njësia përgjegjëse, pranë Bashkisë Vlorë, duhet të ndjekë ecurinë e procesit administrativ, për kryerjen e veprimeve të mësipërme.
4. Për kryerjen e këtij veprimi administrativ, lihet afat 20 ditë, nga marrja dijeni për këtë vendim.
5. Me kalimin e këtij afati, njësia përgjegjëse duhet të njoftojë me shkrim Komisionerin për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil, në lidhje me zbatimin e këtij vendimi.
6. Të njoftohet për këtë vendim Bashkia Vlorë dhe nëpunësi *****.
7. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KOMISIONERI

Pranvera Strakosha